



14.09.2021

 humanitäre Verein      Shoqata Human <b>SUCHEN LICHT</b> <b>SYTË KËRKOJNË</b> Luzern   Schweiz			 REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPSTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVO - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA MARRE NË DORËZIM / PRIMSJE - RECEIVED Nësia org. / Org. Jedinica / Org. Unit      Numri / Broj / Number      Vlera / Vrednost / Value 01      010 / STASI		
---	--	--	--	--	--

Duke u bazuar në nenin 13, 58 dhe 34, të Ligjit mbi Vetëqeverisje Lokale, Nr-03/L040, dispozitave të statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Kryetari i Komunës në Suharekë me datë 14.09.2021, lidhë këtë :

## Marrëveshje Bashkëpunimi dhe Bashkëfinancimi

në mes të

### Shoqatës Humanitare “Sytë Kërkojnë Dritë”

dhe

### Komunës së Suharekës

#### Neni 1

#### Objekt i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi lidhet në mes të Shoqatës Humanitare “Sytë Kërkojnë Dritë”, të përfaqësuar nga **Shqipe Kryeziu, Drejtoresh e përgjithshme**, dhe në mes të Komunës së Suharekës, të përfaqësuar nga **Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës**, me qëllim të financimit të projektit me paisje për personat me aftësi të kufizuara si dhe komunitete të tjera.

#### Neni 2

#### Kushtet për formimin e kësaj marrëveshje

Kjo marrëveshje parasheh furnizimin me paisje për personat me aftësi të kufizuara si dhe komunitete të tjera, për familjet me kushte të rënda ekonomike dhe të cilët nuk kanë kushte minimale për blerjen e këtyre pajisjeve. Komuna me qëllim të krijimit të kushtëve sa më të mira për personat me aftësi të kufizuara, pranon dhe e përkrah lidhjen e kësaj marrëveshje.

#### Neni 3

#### Qëllimi i marrëveshjes

- 3.1 Komuna me qëllim të krijimit të kushtëve sa më të mira për personat me aftësi të kufizuara, pranon dhe e përkrah lidhjen e kësaj marrëveshje.
- 3.2 Sh.H. “Sytë Kërkojnë Dritë” në mënyrë vullnetare, të pavarur dhe vullnetë plotë, obligohet dhe zotohet për sigurimin e pajisjeve për personat me aftësi të kufizuara dhe komunitete tjera.

## **Neni 4** **Obligimet e Shoqatës**

**4.1 Shoqata Sytë Kërkojnë Dritë** është institucioni implementues i këtij projekti i cili parasheh periudhën e dorëzimit të pajisjeve sipas programit.

**4.2 Shoqata Bamirëse “Sytë Kërkojnë Dritë** merr përsiper keto obligime sa i përket qëllimit të këtij memorandumi , si ne vijim ;

Raportimi duhet të bëhet me shkrim para institucioneve të Komunës së Suharekës

## **Neni 5** **Afati i Realizimit**

Afati i realizimit të qëllimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit duhet të arrihet brenda vitit 2021

## **Neni 6** **Obligimet e Palëve**

- 6.1** Vlera e gjithëmbarshme e projektit të donacionit është 12,264.00€
- 6.2** Komuna e Suharekës, do të participoj shumë prej 2,000.00€
- 6.3** Shoqatës Humanitare “Sytë Kërkojnë Dritë” me seli në Luzern të Zvicrës ,do të participoj vlerën tjetër prej 10,264.00€
- 6.4** Vlera e participimit nga Komuna e Suharekës do të transferohet në llogarinë bankare të Shoqatës Humanitare “Sytë Kërkojnë Dritë” , me numër të llogarisë:  
IBAN:CH830900000619096884 me rastin e pranimit të pajisjeve .

## **Neni 7** **Interpretimi dhe Ndryshimi**

- 7.1** Interpretimi i kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit do të bëhet në pajtim me ligjet e Kosovës, duke e ruajtur parimin e reciprocitetit.
- 7.2** Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit mund të bëhen vetëm me shkrim dhe të nënshkruara nga ana e dy palëve.

## **Neni 8** **Zgjidhja e Marrëveshjes**

Palët zotohen se do t'i përmbahen kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit dhe se në rast kontesti eventual apo paqartësie në tekstin e kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit, të zgjidhen me anë të bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim.

### **Neni 9 Shkëputja e Marrëveshjes**

E drejta e shkëputjes së njëanshme të kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit, do të bëhet në rastet e shkeljeve të obligimeve që janë të përcaktuar me këtë Marrëveshje të Bashkëpunimit, duke e njoftuar palën tjetër 30 ditë para shkëputjes së Marrëveshjes.

### **Neni 10 Hyrja në Fuqi**

Kjo Marrëveshje e Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e palëve nënshkruese.

## **PALET NË MARRËVESHJE**

**Shoqata Humanitare "Sytë kërkojnë Dritë"  
Shqipe KRYEZIU**

---

**Drejtoreshë**

**Komuna e Suharekës  
Bali MUHARREMAJ**

---

**Kryetar i Komunës**

14 Shtator 2021  
Komuna e Suharekës